



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZLAnr.29/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu, anëtarë dhe me zyrtarin e lartë ligjore Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD), paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Ferizaj, në seancën e panelit të mbajtur me 15.09.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**HEDHET** si e palejuar ankesa e subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD)

### A r s y e t i m

**PZAP-i**, ka pranuar një ankes nga përfaqësuesi i subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD), kundër Komisionit Komunal Zgjedhor-(KKZ), në Ferizaj, me të cilin pretendon se me datën 14.09.2017 kanë marrë njoftimin nga KKZ në Ferizaj se subjektit politik PD në Ferizaj i takojnë vetëm 24 anëtarë të KVV-së nga 129 sa janë total dhe të cilat i kanë pasur edhe në zgjedhjet e fundit lokale, duke kërkuar që PD të ketë përfaqësim të plotë në KVV pasi që në Ferizaj ky subjekt është i përfaqësuar në asamble.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi bazën juridike për paraqitjen e ankesës, gjeti se:

### Ankesa është e palejuar

Paneli, nuk i shqyrton dhe nuk vendos ndaj njoftimeve të KKZ-ve, por vetëm ndaj vendimeve të KQZ-së dhe me këtë rast parashtresuesi i ankesës nuk ka bazë ligjore për ankimimin e njoftimeve të KKZ-së, sepse është e specifikuar qartë në dispozitën ligjore të nenit 122 Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, se në cilat raste mund të ankimohen vendimet e KQZ-së.

Për arsyet e theksuara më lart dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL. Anr. 29/2017 më datën 15.09.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
Hasan Shala

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.